



Njësia e Prokurimit

Istog: datë, 08.05.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Istogut, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **SKY GROUP SHPK** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RIPARIMI I RRUGEVE LOKALE TE RENDIT IV DHE SANIMI I GJENDJES NGA VERSHIMET** me Nr. të Prok: **633-23-2733-1-1-1**, Nr. të brendshëm **633-23-012-1-1-1** nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Pjeserisht e bazuar, aprovet kërkesa për ri-shqyrtim nga Operatori Ekonomik: **SKY GROUP SHPK** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RIPARIMI I RRUGEVE LOKALE TE RENDIT IV DHE SANIMI I GJENDJES NGA VERSHIMET** me Nr. të Prok: **633-23-2733-1-1-1**, Nr. të brendshëm **633-23-012-1-1-1**, kundër *Njoftimit për Kontrate*, të datës 27.03.2023 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. *Vërtetohet* Njoftimi për kontratë i AK-se, i publikuar me datë: 27.03.2023, dhe ndryshimet e bëra do të publikohen në e-prokurim përmes B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *aktivitetin e Prokurimit ta vazhdoj*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues- Komuna e Istogut sqaron që kërkesat në Njoftim për kontratë dhe Dosje të tenderit janë formuluar në harmoni me natyrën e aktivitetit të prokurimit. Aktiviteti i prokurimit është Sherbim, Vlerë e madhe, Procedure e hapur. Duke u bazuar në titullin e aktivitetit **RIPARIMI I RRUGEVE LOKALE TE RENDIT IV DHE SANIMI I GJENDJES NGA VERSHIMET**- kuptohet qartë që përveq Riparimit të rrugeve të rendit të IV kemi të bëjmë edhe me sanimin e gjendjes nga vershimet- nga të cilat vershime Komuna e Istogut në 3 vitet e fundit ka dëmtuar

konsiderushme materiale. Ne menyre qe te jemi sa me te pergaditur ne rast te vershimeve – edhe jane formuluar Kerkesat te cilat jane relevante-proporcionale me lenden dhe objektin e kontrates.

Tek Kerkesa 2- Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe jane te domosdoshme per realizimin e projektit ndryshohen:

Vendi i tekstit i cili ndryshohet	Ne vend te:	Eshte:
Kapaciteti teknik dhe profesional Kerkesa2- Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe jane te domosdoshme per realizimin e projektit	-Nje(1) Ngarkues me peshe prej 6-7 ton.	-Nje(1) Ngarkues me peshe min.6 ton
	-Nje(1) Eskavator me rrota, me peshe 5-7 ton.	-Nje(1) Eskavator me rrota me peshe min. 5 ton

Per ndryshimet e lartecekuaara do te njoftoheni permes B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara, ndersa Kerkesat tjera mbeten te njejta- te pandryshuara.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit
Gëzim Ademaj